



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Feed-in Tarifës për Hydrocentralet e Vogla

RAPORT KONSULTATIV

DEKLARATË

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRRE në mënyrë që të pranojë komente dhe mendime nga palët e interesuara. Ky dokument nuk duhet të konsiderohet se paraqet një vendim të ZRRE-së.

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Përzgjedhja, Kategorizimi dhe Përcaktimi Kohor

2.1 Përmbushja e Caqeve Indikative

2.2 Përzgjedhja e Hidrocentraleve të Përfshira në Tarifë

2.3 Ndarja sipas Kapaciteteve Prodhuese

2.4 Përcaktimi Kohor i Tarifave

3. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore, Norma e Kthimit (RoR)

3.1 Të Ardhurat e Lejuara për Periudhën 10 Vjeçare

3.2 Kosto e Kapitalit

3.3 Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor

3.4 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Kostove Operacionale dhe Mirëmbajtjes të Lejuara

3.4.1 Kosto Operacionale

3.4.1.1 Kosto e Personelit

3.4.1.2 Kosto e Ujit

3.4.1.3 Kosto të Tjera të Lejuara

3.4.2 Kosto e Mirëmbajtjes

4. Kalkulimi i Tarifës

4.1 Tarifa e një Hidrocentrali

4.2 Tarifa e përgjithshme

4.3 Feed-in Tarifa – Tarifa Nxitëse

5. Ndikimi i Tarifës së Hidrocentraleve të reja në Tarifën e Përgjithshme

Shkurtesat dhe Akronimet

CF – Faktori i Kapacitetit

EP – Energjia e Prodhuar

JE – Jetëgjatësia Ekonomike

Kd – Koeficienti i Drejtimit

KEP – Kostoja e Energjisë së Prodhuar

KI – Kapaciteti i Instaluar

KM – Kostoja e Mirëmbajtjes

KO – Kostoja Operacionale

KOK – Kostoja e Kapitalit

KOM – Kostot Operacionale dhe te Mirëmbajtjes

KU – Kosto e Ujit

MEM – Ministria e Energjisë dhe Minierave

MPKK – Mesatarja e Ponderuar e Kostos se Kapitalit

SHSHEMZHQ – Shoqata Shqiptare e Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm

TAL – Të Ardhurat e Lejuara

TALM – Të Ardhurat e Lejuara Mesatare

TKV – Totali i Kostove Vjetore

VIF – Vlera e Investimit Fillestar

VNF – Vlera Neto e Aseteve ne Fillim të Vitit

VNV – Vlera Neto e Aseteve ne Fund të Vitit

ZHV – Zhvlerësimi Vjetor

1. Hyrje

Koment MK: Ky raport nuk jep elemente të mjaftueshme për të kuptuar arsyen e leshimit të këtij raporti nga ZRRE-ja pasi në dokumentin e prezantuar mungon baza ligjore, andaj edhe krijohen paqartësitë dhe konfuzioni.

Dokumentit i mungon referenca në bazën ligjore që e obligon ZRRE që të bëjë një strukturë tarifore për energjinë e ripërtërishme. Nenet –15.4 (a) dhe 46.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (që lidhen direkt për metodologjinë e tarifave në energji dhe ripërtërishme) është dashtë të përmenden këto dokumente. Poashtu edhe nën 3.1 i Ligjit për Energjinë dhe definicionin e energjisë së ripërtërishme (të ipet referenca e dhënë në këtë raport). Për bazën ligjore të këtij dokumenti kishim me sugjerim edhe nën 15.3 dhe nën 18.4 të Ligjit të Energjisë. Këto nënë ndërlidhen direkt me metodologjinë tarifore për energjinë e ripërtërishme.

Ky raport është përgatitur nga ZRrE me qëllim të parashikimit kuantitativ të kostove të prodhimit të energjisë së ripërtërishme nga kapacitetet e reja dhe është pasqyrë tarifore e këtyre kapaciteteve, **posaçërisht i fokusuar në hidro energji**. Të dhënat kryesisht janë bazuar në dokumentin e titulluar “Studim i parafizibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vogla në Kosovë” përgatitur për Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (MEM) nga Shoqata Shqiptare e Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm (SHSHEMZHQ). Raporti mbulon parashikimin e të ardhurave totale të lejuara që mund të fitohen prej tarifave të rregulluara, dhe parimeve që përcaktojnë strukturën e tarifave të përdorura për mbulimin e këtyre të ardhurave vjetore. Në raport përfshihet metoda e kalkulimit të tarifave të Hidrocentraleve, kapaciteti i instaluar i të cilave varion prej 300kW deri në 8300kW.

Koment MK: Nuk besoj se mund të thuhet “posaçërisht i fokusuar në hidro energji” pasi ky raport është i fokusuar vetëm dhe ekskluzivisht në energjinë e ujit (hidro). Parashikohet pyetja a duhet të fokusohet raporti edhe në burime të tjera të energjisë së ripërtërishme duke pasur parasysh se Udhëzimi Administrativ nr. 06/2007 “Mbi caqet Indikative për Konsumimin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtërishme dhe Kogjenerimi” i miratuar nga MEM-i, përcakton caqet edhe për lloje të tjera të energjisë së ripërtërishme. Cila është arsyeja që kjo metodologji e trajton vetëm energjinë e ujit?

2. Përzgjedhja, Kategorizimi dhe Përcaktimi Kohor

2.1 Përmbushja e Caqeve Indikative

Sasia e energjisë e cila duhet konsumuar nga energjia e ripërtërishme deri në vitin 2016 **diktohet** në dokumentin Udhëzimi Administrativ Nr.06/2007 “Mbi Caqet Indikative për Konsumimin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtërishme dhe Kogjenerimi” të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Këto caqe indikative shihen në tabelën 1:

Koment nga MK: Ne nenin 2.1, përdoret shprehja jo adekuate (“diktohet”). Kjo shprehje duhet te zevendesohet me nje shprehje me te përshtatshme.

Nr.	Burimi i Energjisë	Caqet indikative për konsum të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme (GWh)									
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Hidro	125.84	134.56	145.03	156.31	167.01	178.40	190.50	203.18	216.67	230.39
2	Erë	0.00	0.00	0.00	32.56	68.73	108.51	151.89	199.80	252.14	309.94
3	Solare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Biomasë	0.00	0.00	0.00	0.00	11.63	17.45	19.77	23.26	29.08	29.08
	TOTAL	125.84	134.56	145.03	188.87	247.37	304.36	362.16	426.24	497.88	569.40

Tabela 1

Sipas dokumentit në fjalë, në vitin 2016 duhen konsumuar së paku 230.39 GWh energji elektrike të prodhuar nga Hidro energjia.

2.2 Përzgjedhja e Hidrocentraleve të përfshira në tarifë

Hidrocentralet janë përzgjedhur varësisht prej efikasitetit dhe fizibilitetit të tyre, pasqyrë e së cilës është tarifa e shitjes së energjisë nga gjeneratori tek furnizuesi publik. Fillimisht të arsyeshme janë konsideruar të gjitha ato hidrocentrale të cilat prodhojnë energji me tarifë baraz me ose nën çmimin e importit, duke akumuluar një gjenerim vendor prej 291.67 GWh.(Konstatimi se të gjitha hidrocentralet janë të arsyeshme nëse kanë çmimin më të ulët se importi mund të jetë e natyrës së përkohshme dhe kjo nuk duhet të shërbej si bazë për vlerësimin e tarifës së avancuar(“feed-in tariff”).Ky konstatim në vazhdim të demantohet në pikën 4.1 të këtij dokumenti.Realisht krahasimi në çmim i importit aktual dhe energjisë që mund të ishte prodhuar nga HC në fjalë duhet të i referohet kualitetit që ato paraqesin në një treg aty për aty. Më e afërt krahasimi me çmimet e eksportit që KEK-u realizon nga gjeneratorët e vet.) Mirëpo, meqë sasia e kërkuar e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet e vogla në udhëzimin administrativ është vetëm 145.03 GWh në vitin 2009, energjia e gjeneruar në Kosovë me rastin e ndërtimit të të gjitha hidrocentraleve të vogla, tejkalon këtë cak indikativ, siç mund të shihet në tabelën 2:

Nr.	Burimi i Energjisë	Caqet indikative për konsum të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme (GWh)									
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	Hidro Caku Indikativ	125.84	134.56	145.03	156.31	167.01	178.40	190.50	203.18	216.67	230.39
2	Gjenerimi nga HEC-et e reja	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67	291.67
	Ndryshimi (2) - (1)	165.83	157.11	146.64	135.36	124.66	113.27	101.17	88.49	75.00	61.28

Tabela 2

Prandaj, hidrocentralet të cilat favorizohen në kalkulimin e tarifës për energji elektrike janë ato të cilat me tarifën më të ulët dhe fizibilitetin më të madh përmbushin cakun e lartëpërmendur indikativ.

2.3 Ndarja sipas Kapaciteteve Prodhuese

Në mënyrë që kostoja e vlerësuar të reflektojë sa më saktë **koston reale të hidrocentraleve**, shqyrtimi i tarifave është bërë në tri grupe, varësisht prej kapacitetit të instaluar të hidrocentralit. Ndarja sipas kapaciteteve prodhuese është bërë duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 05/250 “Mbi Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme dhe energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosovë për periudhën 2007-2013”. Vendimi i lartpërmendur **dikton** që tarifat të përcaktohen sipas këtyre kategorive:

Koment nga MK: Shprehja “kosto reale të hidrocentraleve” nuk është adekuate, këtu nuk behet fjale për koston e hidrocentrales por “kosto reale e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet”. Poashtu shprehja “dikton” sugjerojmë që të zevendesohet me shprehjen tjetër adekuate.

- I. Kapaciteti i instaluar prej 0 MW deri në 2 MW
- II. Kapaciteti i instaluar prej 2 MW deri në 5 MW
- III. Kapaciteti i instaluar prej 5 MW deri në 10 MW

2.4 Përcaktimi Kohor i Tarifave

Duke marrur parasysh koston e investimit dhe kohën mesatare të maturitetit të kredive për investime të mëdha dhe afatgjata është vendosur që tarifa të llogaritet si një mesatare për 10 vite.

Koment nga MK: Duhet të vlerësohet arsyeshmeria e afatit 10 vjecar për tarifat kur dihet shumë mirë se vendet kryesisht e kanë miratuar periudhën 15- 20 vjecar si periudhë optimale.

3. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore, Norma e Kthimit (RoR)

3.1 Të Ardhurat e Lejuara për periudhën 10 vjeçare

Me “Të Ardhurat e Lejuara” nënkuptojmë kalkulimin e parashikuar të shumës së të hyrave të nevojshme për të mbuluar koston totale vjetore të investitorit, duke përfshirë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimin e aseteve dhe kthimin e lejuar.

Të ardhurat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:

$$TAL = KOM + ZHV + KOK \quad (1)$$

TAL = Të Ardhurat e Lejuara

ZHV = Zhvlerësimi Vjetor

KOK = Kostoja e Kapitalit

KOM = Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes




Figura 1: Skema e llogaritjes së të ardhurave të lejuara

Sipas asaj se çmimet sipas nivelit të kapacitete janë përcaktuar dhe se HC që mund të rehabilitohen nuk konsiderohen posaçërisht atëherë RAB-i fillestar më duket i panevojshëm në skemën e lartme sepse investimet e reja janë baraz me RAB përfundimtar.

3.2 Kostoja e Kapitalit

Kostoja e kapitalit është llogaritur duke shumëzuar mesataren e ponderuar të koston së kapitalit me vlerën neto të aseteve në fund të vitit

$$KOK = MPKK * VNF$$

KOK – Kostoja e Kapitalit

VNF – Vlera Neto e Aseteve në fund të vitit

Ku

$$\text{dhe } MPKK = (1-g) * (r_f + ERP_i) + g * (r_f + DRP_i) = 13.8\% \quad (3)$$

MPKK – Mesatarja e Ponderuar e Koston së Kapitalit

g – Leverazhi (Koeficienti) i borxhit (borxhi / borxhi + ekuiteti)

r_f – Norma pa rrezik

ERP_i – Premia e rrezikut të ekuitetit për kompaninë i

DRP_i – Premia e rrezikut të borxhit për kompaninë i

MPKK përdoret për kalkulimin e kthimit të lejuar dhe prezanton koston e vlerësuar të financimit për gjeneratorin. MPKK është një mesatare e ponderuar e koston së financimit nga borxhi dhe ekuiteti, ku secila nga këto shprehet si normë pa-rrezik (duke prezantuar

koston e financimit për asetet pa rrezik) plus premia e rrezikut që prezanton rreziqet shtesë në huamarrje nga gjeneratori ose blerja e ekuitetit në gjenerator.

Fitimi i përlllogaritur në krahasim me koston aktuale të financimit përdoret për të ofruar stimulim për gjeneratorin që të kërkojë financim komercial me një kosto mbi (nëse i referohemi pikës 4.3 kjo dmth mbi koston e WACC-ut për 10-15%) MPKK-në përcaktuar nga ZRRE-ja në shqyrtimin e tarifave të mëparshme për KEK dhe KOSTT.

3.3 Zhvlerësimi Vjetor

Zhvlerësimi vjetor është kalkuluar në menyrë lineare duke supozuar jetëgjatësi të aseteve prej 35 vite. Pra,

$$ZHV = VIF * \left(\frac{100\%}{JE} \right) \quad (2)$$

ZHV = Zhvlerësimi Vjetor

VIF = Vlera e Investimit Fillestar

JE = Jetëgjatësia Ekonomike

3.4 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Kostove Operacionale dhe Mirëmbajtjes të Lejuara

3.4.1 Kosto Operacionale

Kostot operacionale të pranuar për tarifa përfshijnë kostot e personelit, kostot e ujit të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ mbi Strukturën e Pagesave të ujit dhe Kostot e tjera.

3.4.1.1 Kosto e Personelit

Në studimin e MEM, është vlerësuar se kostot operacionale nuk varen shumë nga fuqia e instaluar dhe variojnë mes 45.000 deri 60.000 €/vit.

Duke pasur parasysh këtë fakt, është vendosur që këto kosto të aplikohen në mënyrë lineare varësisht nga kapaciteti i instaluar. Hidrocentrali më i vogël ka kapacitet të instaluar prej 300kW. Këtij hidrocentrali i shoqërohet kostoja operacionale minimale prej 45,000 € Hidrocentrali më i madh ka kapacitet të intaluar prej 8300 kW të cilit i pranohet kostoja operacionale maksimale prej 60,000€ në vit. Këto kombinime të Kapacitetit të Instaluar dhe Kostos Operacionale, mund të paraqiten si

$$P_1 = (KI_1, KP_1) = (300, 45.000) \text{ dhe } P_2 = (KI_2, KP_2) = (8.300, 60.000) \quad (4)$$

Ku

$$(KP_2 - KP_1) = kd * (KI_2 - KI_1) \quad (5)$$

$$Kd = \text{koeficienti i drejtimit} = \left(\frac{\Delta KP}{\Delta KI} \right) = \left(\frac{KP_2 - KP_1}{KI_2 - KI_1} \right) = \left(\frac{15}{8} \right) \quad (6)$$

$$KP_2 - 45,000 = \left(\frac{15}{8}\right) * (KI_2 - 300) \quad (7)$$


Prandaj, të gjitha hidrocentraleve me kapacitet të instaluar prodhues në mes 300kW dhe 8300kW ju pranohet kostoja e personelit sipas formulës:

$$KP = \left(\frac{15}{8}\right) * KI + 44,437.5 \quad (8)$$

KP = Kostot e Personelit

KI = Kapaciteti i Instaluar

Kjo metodologji i përcaktimit të kostove të stafit si një vlerë e cila mund të ndryshoi linearisht ndoshta ka shërbyer në vlerëm por ashtu si sqarohet tabela e çmimeve në pikën 4.2 janë zgjedhur tri pika të drejtëzës në diagramin e mëposhtëm. Ndoshta duhet sqaruar kjo se duke vlersuar këto kost se si është përvetësuar për nivelet e tarifave të avansuara tëpropozuara.



Grafiku 1

3.4.1.2 Kosto e Ujit

Përcaktimi i kostos së lëndës së parë (Ujit) është bazuar në dokumentin “Udhëzimi Administrativ mbi Strukturën e Pagesave të Ujit.” Neni 2 i po të njëjtit dokument citon “Kompensimi për shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe ujërave minerale përcaktohet në lartësi për: Prodhuesit e energjisë elektrike për çdo

kilovat-orë të prodhuar në hidrocentral 2.5% të çmimit të shitur”. Për këtë arsye, Kostoja e ujit i është shtuar tarifës përfundimtare sipas udhëzimit të lartpërmendur administrativ.

3.4.1.3 Kosto të Tjera të Lejuara

Në këto kosto përfshihen shpenzimet e tjera të pa-kalkuluara të cilat janë përafërsuar në vlerë prej 10% shtesë mbi totalin e kostove. Këtu përfshihen shpenzimet e sigurimit, shpenzimet e karburantëve, shpenzimet e meditive, shpenzimet e interesit, detyrimet komunale dhe shpenzimet e tjera të pa parashikuara. (Vlera prej 10% është vlera e përafërt e shpenzimeve të po kësaj kategorie të "Triangle General Contractors, Inc.")

3.4.2 Kosto e Mirëmbajtjes

Studimi i MEM ka vlerësuar se kostot e mirëmbajtjes të një hidrocentrali duhet të jenë 1.5% e vlerës së investimit kryesor dhe priten të jenë konstante edhe për vitet që pasojnë.

4. Kalkulimi i Tarifës

4.1 Tarifa e një Hidrocentrali

Me "Tarifa" nënkuptojmë koston totale mesatare per kWh të nevojshme për të mbuluar së paku të ardhurat vjetore të lejuara, siç janë kalkuluar në pjesën 3.1 të këtij raporti.

Tarifa e një hidrocentrali të vetëm është llogaritur duke kalkuluar mesataren e të ardhurave të lejuara për 10 vite në raport me sasinë e energjisë së prodhuar. Matematikisht,

$$TARIFA = \left(\sum_{i=1}^{10} \frac{TAL_i}{i} \right) * \frac{1}{EP_1} = TALM * \frac{1}{EP_1}, \text{ për çdo i hidrocentral} \quad (9)$$

TAL_i – Të Ardhurat e Lejuara për vitin *i*

EP_i – Energjia e prodhuar nga hidrocentrali në fjalë

TALM – Të ardhurat e lejuara mesatare për 10 vite

Energjia e prodhuar (EP) nga një hidrocentral kalkulohet me shumëzimin e Faktorit të Kapacitetit (0-100%) me vlerën maksimale të energjisë që mund të prodhojë një hidrocentral. Faktori i kapacitetit është marrë nga studimi i MEM dhe është indikator në mes raportit të totalit të kWh të prodhuar nga rrjedhja e parashikuar e ujit krahasuar me vlerën teorike maksimale të prodhimit sikur uji të rrjedhte tërë vitin në mënyrë të pandërprerë. Mesatarja e faktorëve të kapacitetit të të gjitha impianteve i dhënë në studimin e MEM-it është 53%, që implikon se të gjitha hidrocentralet mesatarisht do të jenë në gjendje të prodhojnë maksimumin e kapacitetit të tyre 53% të kohës. Duhet potencuar se ky numër mund të jetë i mbivlerësuar duke konsideruar faktin se hidrocentrali **Triangle General Contractors (Lumbardhi) vitin e kaluar ka prodhuar me një faktor kapaciteti prej 33%**. Faktori i Kapacitetit ndikon ndjeshëm në vlerën e tarifave prandaj përcaktimi sa më i saktë i tij është tejet i rëndësishëm.

4.2 Tarifa e Përgjithshme

Kalkulimi i tarifës së përgjithshme është bërë duke mbledhur Mesataren e Të Ardhurave të Lejuara (TALM) 10 vjeçare për secilën nga impiantet, dhe duke pjesëtuar këtë me shumën e sasisë së prodhuar nga të gjitha impiantet në studimin e MEM (Mesatarja e ponderuar e kostove të parashikuara nga të gjitha impiantet). Matematikisht,

$$TARIFA = \frac{\sum_{j=1}^m TALM_j}{\sum_{j=1}^m EP_j}, \text{ ku } j \text{ paraqet hidrocentralin përkatës} \quad (10)$$

$TALM_j$ = Të Ardhurat e Lejuara Mesatare 10 vjeçare për hidrocentralin j
 EP_j = Energjia e prodhuar nga hidrocentrali j

Kalkulimet e fituara në bazë të kësaj metodologjie, kanë diktuar që tarifat e kategorizuara të duken si vijon:

Kapaciteti I Instaluar	Tarifa (Eurocent/kWh)
Hidrocentrale deri në 2MW	6.44
Hidrocentrale nga 2MW deri në 5 MW	5.02
Hidrocentrale nga 5MW deri në 10 MW	4.02

Tabela 3

4.3 Feed-in Tarifa – Tarifa Nxitëse

Në mënyrë që tarifat e propozuara të sigurojnë joshje të investimeve në HEC-et e vogla nga investitorë të jashtëm dhe kthim të arsyeshëm të investimeve, shtetet të cilat aplikojnë feed-in tarifa ofrojnë masa të ndryshme nxitëse. ZRrE propozon që tarifës së fituar nga të ardhurat e lejuara t'i shtohet pjesa nxitëse prej 10%-15% të kostos së prodhimit të energjisë. Meqë është racionale që caqet indikativë të përcaktuara nga MEM të përmbushen me koston më të ulët dhe përballueshmërinë më të madhe për konsumatorin, propozohet që tarifa nxitëse të jetë më e madhe për hidrocentralet me kosto më të ulët të prodhimit të energjisë në mënyrë që të joshë ndërtimin e hidrocentraleve më fizibile. Më saktësisht, ZRrE propozon që tarifa nxitëse mbi koston e prodhimit për hidrocentralet me kapacitet të instaluar nga 5 MW deri në 10MW të jetë 15% ndërsa për hidrocentralet më të vogla të jetë vetëm 10%.

Koment nga MK: Si eshte ardh deri tek 10 % respektivisht 15% ? A eshte bere ndonje studim per te krahasuar cmimet e feed-in tarifes ne rajon? Une i kam shiquar disa analizat

(shih p.sh. web sajtin: <http://www.optres.fhg.de/>) dhe shof qe tarifa nxitese mund te jete shume me e madhe. Ne baze te asaj se cka mund te shihet nga studimet te vendeve qe tash kane filluar stimulimin e prodhimit te energjise nga energjia e ripërteritshme praktika me e mire eshte ajo e disanjimit te tarifave hap as hapi, ne kuptim se edhe ne teknologjine e njejte (p.sg. hidro) vleresohen dallimet qe paraqiten gjate prodhimit gjegjesisht konditat qe afektojne prodhimin e qe ndikojne ne prodhim.

Raporti i “Optres” per shembull rekomandon qasje specifike per enegjine e ripërteritshme qe sigurin zhvillim te duhur “ **for different types of renewable energy in order to determine price, essentially, it takes into consideration different costs of various types and sizes of production, looking at technology development, geographic considerations etc** “. Praktikant te sukseshme ne keto tarifate tregojne se kjo tarifa dallojne varesisht nga teknologjite te ndryshme (biomass, solar, te erës etj.).

Sipas raportit ne fjale por edhe nga studime te tjera rezhimi tarifor per teknologji te reja dallon prej asaj qe aplikohet per teknologji te vjetra, dhe sa me e re eshte teknologjia aq eshte edhe tarifa me e ulet. Kjo per arsye qe te zhvillohet eficienta. Norma e zvoglimit te tarifave vjetore (“tariff degression” bazohet ne: ” empirically derived progress ratios for the different technologies and based on the site, yield/generation costs of each particular plant, with periodic review to assess the price in light of technological and market developments”.

Me posht gjeni nje table nga studimi krahasues ne Europe qe e merr per baze infomatat e vitit 2006 e qe une e kam kopjuar ketu sa per infommim tuaj. Prej tabelës me posht shihen nivelet e tarifave, zvoglimi i tarifave dhe tarifate te ndryshme.

Country	Purchase obligation	Stepped Tariff	Tariff degression	Premium option	Equal Burden Sharing?	Forecast obligation
Austria	x	x	-	-	X ¹⁾	-
Cyprus	x	x	-	-	-	-
Czech Rep.	x (for fixed tariff)	x	-			
Denmark	x (except for wind onshore)	x	-	x (wind)	X ¹⁾	-
Estonia	x (for grid losses)	-	-	x (new draft)	x	x (new draft)
France	x	x	x (wind)	-	x	-
Germany	x	x	x	-	X ¹⁾	-
Greece	x	x	-	-	x	-
Hungary	x	-	-	-	x	-
Ireland	x	x	-	-	x	-
Italy	x	x	x (PV)	-	x	-

Lithuania	x	-	-	-	x	-
Luxembourg	x	x	-	-	x	-
Netherlands ³⁾	-	x	-	x	2)	-
Portugal	x	x	-	-	x	-
Slovakia	x (for grid losses)	x	-	-	x	-
Slovenia	x (for fixed tariff)	x	-	x	x	x
Spain	x (for fixed tariff)	x	-	x	x	x

1) Austria, Denmark and Germany apply an equal burden sharing with advantages for electricity intensive industries (see chapter 4).

2) In the Netherlands each electricity consumer contributes the same amount of money to RES-E support, regardless of the amount of electricity consumed (see chapter 4).

3) In the Netherlands no FITs are paid for electricity from RES-E plants that applied for support after the 18th of August 2006.

Koment nga MK: Poashtu praktikat te mira te disa venedeve qe jane ne fazen fillestare kane treguar edhe tendecen qe te percaktohen tarifat ne menyre qe te parashihet zbritja e tyre vjetore qe te stimulohet investimi “cost-effective” dhe zhvillim i teknologjise. Ne kete studim nuk parashihet mundesia e tille e as mundesia e modifikimit te tarifave. Poashtu ”feed – in tariffa” paraqitet si nje obligim per furnizuesin qe te bleje nje sasi te kesaj energjie nga prodhuesi me cmim te percaktuar qe te imponohet energjia e ripërteritshme dhe per te siguruar investimi, gjersa ky studim nuk permend kete fakt dhe nuk jep metodën e implementimit te tij.

5. Ndikimi i Tarifës së Hidrocentraleve të Reja mbi Tarifën e Përgjithshme


Gjendja momentale energjetike në Kosovë ka diktuar që në vitin 2007 të importohen 539.9 GWh energji elektrike me një çmim mesatar prej 84€/MWh, dhe gjendja energjetike tarifore është dukur si vijon:

	Gjenerimi Vendor			Importi	Totali	Tarifa (€/MWh)
	KEK	UJMANI	TGC			
Gjenerimi (MWh)	4407300.0	76000.0	28000.0	539812.0	5051112.0	26.47
Çmimi	€ 19.4	€ 24.0	€ 40.0	€ 83.8		
Vlera	85,523,096.32	1,824,000.00	1,120,000.00	45,230,847.48	133,697,943.80	

Tabela 4

Me rastin e futjes në kalkulim të kapaciteteve të reja prodhuese, gjenerimi vendor rritet për 154.8 GWh në vit, me çmim më të vogël krahasuar me atë të importit. Prandaj, është racionale që kjo shumë e energjisë t'i zbritet shumës së importuar. Mirëpo, meqë të gjitha hidrocentralet në fjalë janë hidrocentrale rrjedhëse, nuk mund të diktohet se kur prodhohet hidro-energja, dhe duhet përafërsuar korrelacionin mes hidro energjisë së prodhuar dhe energjisë së importuar. Duke konsideruar kërkesën në ngritje të energjisë

në vend, dhe faktin se importi i energjisë realizohet kryesisht në orët e pikut, është parashikuar që hidro energjia mund të zëvendësojë vetëm 33% të energjisë së importuar ngase kjo përqindje koïncidon me intervalin kohor të pikut.



Grafiku 2

Në rast se trendi i ngritjes së kërkesës së energjisë në vend nuk pëson ndonjë ndryshim, dhe të gjitha hidrocentralet e shqyrtuara ndërtohen, tarifa e përgjithshme do të ishte për 3.8% më e ulët, tarifë kjo e cila shkon në favor të konsumatorit. (ky konstatim dhe tabela e mëposhtme paraqet situatën aktuale dhe nuk mund të referohet një periudhe afatgjate prej 10 vitesh për sa synohet vleftëshmëria. Prandaj propozoi të fshihet.)

	Gjenerimi Vendor						Totali	Tarifa (€/MWh)
	KEK	UJMANI	TGC	Hidro Te Reja		Importi		
Gjenerimi (MWh)	4407300.0	76000.0	28000.0	34090.9	84741.1	150834.2	359874.7	5,140,840.93
Çmimi	€ 19.4	€ 24.0	€ 40.0	€ 64.42	€ 50.21	€ 40.22	€ 83.7	25.50
Vlera	85,523,096.32	1,824,000.00	1,120,000.00	2,196,178.61	6,066,630.29	4,255,195.88	30,107,474.49	131,092,575.58

Tabela 5